



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.07.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.06.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik "SELMANS NETWORK" Sh.p.k. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike", Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004-511, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "SELMANS NETWORK" Sh.p.k, e dt.28.06.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ri-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike", Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004-511, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 24.06.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 24.06.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "SELMANS NETWORK" Sh.p.k, me dt.28.06.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike", Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.07.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me LPP-në, nuk qëndron, sepse Autoriteti kontraktues në pajtim me nenin...të LPP-së, ka rekomanduar për kontratë Grupin e operatorëve ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Pretendimi juaj lidhur me Aneksin 1 të specifikimeve teknike të detyrueshme nuk qëndron, sepse Grupi i operatorëve ekonomik I rekomanduar për kontratë, ka paraqitur deklaratën siç është kërkuar në FDT-ë;

Kërkesa e Autoritetit kontraktues në FDT-ë, nuk ka qenë që OE të dorëzoj deklarat se mostrat do t'i ketë të gatshme për prezantim, por që OE së bashku me ofertën të dorëzoj mostrat, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron;

Pretendimi se Grupi I operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka paraqitur deklarata dhe dokumente mashtruese nuk qëndron, sepse vërtetimi I kësaj nuk është kompetenc e Autoritetit kontraktues;

Sa ju përket pozicioneve 3,4,5,6,Autoriteti kontraktues I konsideon devijime të vogla( neni 59.4 LPP) prandaj edhe ky pretendim I juaji nuk qëndron;

Pretendimi lidhur me autorizimet dhe garancionet për produktet në pozicionet 193 dhe 197, nuk qëndron, dhe I njëjti plotëson kërkesën e Autoritetit kontraktues në FDT-ë;

Sa I përket Grupit të operatorëve ekonomik N.S.H.T."Viktory Com"; "Marisa" sh.p.k.; "Taifor" sh.p.k., Autoriteti kontraktues të njëjtin e ka eliminuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te këtij vendimi.**

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;

